



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURES  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 480 Prot.

Tiranë, më 03.04 2018

**VENDIM Nr. 63, datë 20.03.2018**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4, datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Topografia Epidamne-Dyrrhachion, Durrës"2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. As. Eduard Shehi, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Topografia Epidamne-Dyrrhachion, Durrës"2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. As. Eduard Shehi, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:

- Ndërhyrje në strukturat romake në lindje të Forum-Macellum, që synojnë të njohin më tej urbanistikën e qytetit romak. Do të realizohet pastrimi i strukturave, rilevimi i tyrë dhe realizimi i sondazheve në thellësi, në varësi të situatës në terren. I gjithë territori do të rikthehet në gjendjen e mëparshme si dhe do të lihet i pastruar dhe i vizitueshëm;
- Gërmim në lulishten e Pallatit të Sportit, i cili synon të identifikojë tiparet që kanë karakterizuar zgjerimin apo ngushtimin e qytetit antik drejt lindjes dhe verilindjes. Do të realizohen dy sondazhe, një në këndin verilindor dhe një në këndin jugperëndimor;
- Gërmim në pjesën perëndimore të qytetit (pranë ish Muzeut Arkeologjik) i cili synon të verifikojë shtrirjen e urbanizimit antik në ekstremin perëndimor, pranë bregut të detit;
- Gërmim në mes të kullave D dhe E, me qëllim verifikimin e një teorie sipas së cilës fortifikimi i antikitetit të vonë mund të jetë mbivendosur tek strukturat

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855


email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)

periferike të amfiteatrit, si dhe nëse kemi të njëjtën situatë kronologjike të fortifikimit si ato të zbuluara në vitet e kaluara. Pas përfundimit të gërmimeve territori do të rikthehet në gjendjen e paragërmimit.

2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2018.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**

**RUDINA ZOTO**

---

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)